



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1143/1 prot.

Tiranë, më 06. 10. 2021

V E N D I M

Nr. 188, datë 06. 10. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 70, datë 14.04.2021, të M. L., ku pretendohet diskriminim për shkak të *bindjeve politike*¹ dhe *çdo shkak tjetër*², nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) pretendon se me datën 23.02.2021 nëpërmjet e-mailit dhe me shkresën nr. 3702 prot., datë 24.02.2021, i është drejtuar punëdhënësit të tij, G. G, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe disa drejtuesëve të tjerë të administratës doganore, me një letër denoncuese për kontrabandën që bëhej në sistemin doganor shqiptar.

Pasi nuk ka marrë asnjë reagim prej tyre, këtë informacion ia ka përcjellë me e-mail Drejtorit të Krimin Ekonomik në Policinë e Shtetit dhe Zëvendës Drejtorit të Policisë Tiranë. Ndërkohë që ankuesi priste reagimin e punëdhënësit të tij, edhe pse në gjendje jo të mirë shëndetësore, ka shprehur vullnetin e tij për pjesëmarrje në kontrollet që do të organizoheshin për të verifikuar parashtrimet e tij.

¹ Ankuesi pretendon se nuk ka bindje politike, por etiketohet nga drejtuesit e tij si pjesë e Partisë Demokratike.

² Për shkak të denoncimeve për kontrabandën e kryer në sistemin doganor shqiptar.

³ Në vijim DPD

Pavarësisht gadishmërisë së ankuesit, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, pa respektuar asnjë procedurë ligjore, pa u dëgjuar apo thirrur, është marrë vendimi i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në ditën që ankuesit i mbaronte raporti mjekësor.

Në vitet 2005-2013, ankuesi sqaron se ka ushtruar detyrën e punonjësit të Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërues i një prej drejtuesëve të lartë të Partisë Demokratike, por nuk ka qënë asnjëherë anëtarë i ndonjë subjekti politik. Në vitin 2013, gjatë fjalës së mbajtur në Kuvendin e Shqipërisë, nga ana e një prej drejtuesve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, është cituar se: “...kemi marrë në punë si drejtor të antikontrabandës M. L., shoqëruesin e J. T. të Partisë Demokratike”.

Sipas ankuesit, përpara vendimit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, është njoftuar nga ana e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për emërimin e tij në një detyrë më të ulët. Për më tepër, ankuesi thekson se i është drejtuar disa herë punëdhënësit me e-mail dhe me postë, për të përfituar diferencat e pagës që i takonin, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ankuesi pretendon se nga ana e punëdhënësit është etiketuar si pjesë e Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe janë përdorur terma si p.sh.: *spion i PD-së, e hoqën njeriun që çonte e-maile te PD.*

Me e-mail datë 08.06.2021, M. L. informoi Komisionerin ndër të tjera se: “*Largimi im nga detyra këtë herë është bërë pas një shkrese denoncuese drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave G. G., ku ndër të tjera si pjesë e denoncimit unë përmend edhe strukturën e Hetimit Doganor që Drejtori Përgjithshëm i Doganës, G. G., ka adresuar problemin për zgjidhje, duke më bërë ftesë për dhënie shpjegimesh para një strukture, të cilën unë e kam cituar nominalisht në shkresën time denoncuese si pjesë e problemit në dogana. Në rastin konkret mendoj se kemi konflikt interesi pasi denoncimin tim mund ta hetojë kushdo tjetër përveç Hetimit Doganor, në varësi të G. G.*

Në fillim të muajit mars 2021, u jam drejtuar eprorëve të mi me një email, për marrjen e lejes të zakonshme (të pakryer) të vitit 2020, si dhe për shkak se në muajin dhjetor 2020, kisha kaluar Covid -in i cili më la pasoja në pikën ku gjithmonë kam patur probleme, me hernien diskale. Leja e zakonshme e cila ju dha të gjithë të tjerëve, si p.sh.: Shefit të Sektorit të Monitorimit në Terren, Specialistit të kësaj zyre dhe me dijeninë time 10 personave të tjerë, mua mu refuzua me pretekstin se kemi ngarkesë në punë.

Këtu dua të ndalem pak, pasi sektori që unë mbuloja ishte ai i antikontrabandës detare ku praktikisht vetëm emrin ka të tillë pasi asnjë mjet i saj, motovedetë, nuk del në det për shkak të amortizimit dhe në këtë sektor shumë të rëndësishëm dërgohen njerëz të cilët nuk i duan nëpër këmbë apo që duan ti "persekutojnë", pikërisht për faktin se ky sektor nuk bën asgjë edhe pse 90 % e kontrabandës bëhet nëpërmjet detit...Të gjitha problemet e evidentuara i kam paraqitur nëpërmjet shkresave zyrtare apo me e-mail Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Në këtë mënyrë leja vjetore e vitit 2020, mu refuzua pasi plani i tyre ishte të me shkarkonin sa më shpejt të ishte e mundur, për shkak të emailit që tërboi gjithë sistemin doganor. Me denoncimin e bërë për problemet madhore të sistemit doganor, tashmë isha armiku i klasës dhe si i tillë mund të përbëja problem si në rastin kur në doganën e Tiranës u bllokua një subjekt dhe unë i kërkova Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave edhe pse isha i sëmurë me raport, të merrja pjesë në kontroll, pasi ky subjekt kishte mallra kontrabandë. Në të njëjtën kohë, duke ditur se po përgatitej

manipulimi i praktikës doganore një email zyrtar ja dërgova edhe Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe atij të Krimet Ekonomik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë. Dua t'ju informoj se këtë praktikë unë e kam ndjekur edhe në muajin qershor 2020, ku gjatë kontrollit të një subjekti kërkova mbështetje nga Drejtoria për Krimet Ekonomike dhe Financiare, si dhe OPGJ të Prokurorisë Tiranë të cilët u vunë në dispozicion dhe në atë kohë nuk u quajt humbje besimi, përkundrazi forcim bashkëpunimi.

Si pasojë e problemeve shëndetësore, më datë 2 mars 2021, mora raport 14 ditë dhe u paraqita në detyrë në datë 17 mars 2021, datë në të cilën më komunikohet vendimi për lirim nga detyra pa asnjë paralajmërim me shkrim, pa asnjë vërejtje, pa asnjë motivacion logjik, situatë e njëjtë si në vitin 2015, duke shkelur haptazi çdo normë ligjore, por edhe morale. Në vitin 2015, si pasojë e largimit të pa drejtë nga detyra kam përfituar rreth 3,600,000 lekë ose afërsisht 25.000 euro, dhe gjyqet kaluan një kalvar plot tre vjeçar. E njëjta gjë po ndodh edhe sot ku aktualisht kam fituar shkallën e parë në gjykatën administrative për njohjen e statusit të nëpunësit civil të mohuar me shumë dëshirë dhe pasion nga DPD...

Gjatë ushtrimit të detyrës si Drejtor i Antikontrabandës Tokësore, kisha në varësi rreth 80 persona dhe 3 sektorë, si dhe të gjitha pikat doganore në vend. Kam udhëtuar me mjetin tim tip Toyota, mijëra kilometra, ku një ndër ditët e shërbimit mjete im u godit nga një gur i vogël në xhamin e parë duke u krisur. Pasi përpilova raport shërbimi me 5 firma, dhe pasi ja dorëzova atë sipas hierarkisë, komisioni i mbledhur nga G. G., vendosi që unë të gjobitesha 300 euro. Deri këtu asgjë anormale dhe unë do isha dakord me gjobën edhe pse vlera reale e xhamit kushtonte 70 euro, por kam disa pyetje përse i përket logjistikës dhe logjikës që G. G. ka për rastin në fjalë:

- A ka patur raste të vjedhjes se mjeteve dhënë personave të cilët ligjërisht nuk duhet të kishin fare mjete?
- A ka pasur raste të dëmtimeve të mjeteve të doganave me pasoja të rënda dhe me vlera qindra mijëra euro nga stafet doganore?
- Nëse ka patur, sa është vlera dhe sa është dëmi?
- A ka ndjekur DPD ndonjë praktikë të ngjashme si në rastin tim, nëse po, kur është aplikuar për herë të fundit dhe çfarë masash janë marrë?
- A e di G. G. se mjetit tim Toyota përveç gomave të gjitha shërbimet unë ia kam bërë vetë pasi magazina nuk kishte furnizim edhe pse në inventar ato janë tërhequr, por kurrë me firmën time?
- A është vënë në dijeni të rasteve flagrante G. G. nga ana ime për abuzimet në fjalë të dërguara me email dhe çfarë masash ka marrë?
- A është ngritur ndonjë herë grup pune dhe auditimi qoftë edhe për të hedhur poshtë pretendimet e mia?

Një tjetër problem ka qenë se, gjatë ushtrimit të detyrës time, kam konstatuar me dhjetra raste abuzimesh nga ana e vartësve të mi dhe kam marrë nismën për të nxjerrë para komisioneve disiplinore për më shumë se 70% të stafit që kisha në varësi. E gjithë kjo procedurë është kryer duke u bazuar dhe zbatuar legjislacionin doganor, si dhe duke evidentuar me fakte dhe prova të gjitha shkeljet e kryera nga secili punonjës.

Në fund, nuk u mor asnjë masë për shkeljet e tyre, por ndodhi e kundërta. Kam disa pyetje drejtuar Drejtorisë së Personelit: se sa raste ka lënë pa shqyrtuar komisioni disiplinor dhe pse i ka lënë?...

Gjatë ushtrimit të detyrës time, vetëm nga indiferenca e strukturave përgjegjëse doganore, një nga këto dhe Drejtoria Antikorrupsion të cilat nuk zbatuan kurrë detyrat e tyre funksionale, unë dhe familja ime jemi kërcënuar me jetë nga vartësit e mi. Për këtë rast kam bërë edhe kallëzim pranë Komisarariatit Nr. 2 Tiranë. Bashkëngjitur po ju mundësoj një kopje të kallëzimit. Kërcënimi erdhi si pasojë e denoncimit për një punonjës, i cili në një hark kohor 1 vjeçar kishte shkaktuar dëm ekonomik në shuma të mëdha dhe duhej të ndiqej penalisht për afëra të tjera korruptive...”

Përsa më sipër, ankuesi sqaron se largimi i tij nga puna lidhet me denoncimin që ka paraqitur tek punëdhënësi, sa i përket kontrabandës që zhvillohet në sistemin doganor dhe faktin që ai mendohet se është anëtarë i Partisë Demokratike të Shqipërisë.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për shkaqet sipërcituara dhe rregullimin e pasojave diskriminuuese.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 632/1 prot., datë 27.04.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁴ DPD-së, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Në përgjigje përsa më sipër, DPD, me anë të shkresës⁵ nr. 7562/1 prot., datë 10.05.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se:

“...a) Ankuesi ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Administratës Doganore me datë 17.10.2013, në detyrën Drejtor i Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit.

b) Me urdhër datë 13.08.2014 është transferuar në detyrën Drejtor i Drejtorisë së Informacionit.

c) Me urdhër datë 16.03.2015 është transferuar nga Drejtor i Drejtorisë së Informacionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në Specialist Analizë/Risku/Aposterior/Jurist Borxhi, pranë Degës Doganore Qafë Botë Sarandë.

Bazuar në vlerësim e rezultateve individuale në punë (jokënaqshëm), si dhe rezultatet e trajnimit të detyrueshëm në përfundim të afatit të periudhës së proves, nuk është konfirmuar Nëpunës Civil (liruar nga shërbimi civil me Vendim Nr.13467/1 prot., datë 04.06.2015). Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë, me vendimin e saj nr. 4747, datë 30.09.2015, lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vendosur ndër të tjera edhe: “Rikthimin e M. L. në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Informacionit pranë DPD”.

d) Në zbatim të urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovaconin në Administratën Publike, M. L. është thirrur nga Komisioni i Posaçëm, dhe me deklaratë të nënshkruar prej tij me datë 31.10.2018 ka dhënë pëlqimin dhe ka pranuar të punësohet në kategorinë B, në pozicionin Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Morinë.

e) Është emëruar nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Drejtori i Përgjithshëm i DPD, në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Kukes (Morinë).

- Referuar kërkesës nr. 572 prot., datë 10.01.2019 të nënshkruar prej tij, me datë 10.01.2019, M. L. ka dhënë pëlqimin për t’u pozicionuar në një pozicion pa status nëpunësi civil, pranë DPD-

⁴ Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.
- Kopje e vlerësimeve të punës të subjektit ankues për tre vitet e fundit, nëse ka.
- Kopje të shkresave/e-maileve të shkëmbyera ndërmjet ankuesit dhe përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sa i përket dononcimeve të kryera prej tij.
- Një kopje e dosjes personale të M. L.
- Informacion (për periudhën 2019-2021) nëse ka patur punonjës të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të cilët kanë paraqitur denoncim pranë eprorëve të tyre, lidhur me shkelje të kryera nga administrata e DPD-së. Nëse po, si është vepruar në këto raste?
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit (akti i emërimit), nëse ka patur punonjës të emëruar në pozicionin që ka mbajtur më parë M. L.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 632/2 prot., datë 11.05.2021

së dhe me aktin nr. 2257 prot., datë 25.01.2019 i kanë përfunduar marrëdhëniet në shërbimin civil në pozicion Përgjegjës Sektori në Sektorin e Operacioneve Doganore në Degën Doganore Kukës (Morinë).

- Pas përfundimit të marrëdhënies së shërbimit civil, ka vijuar të jetë pjesë e strukturës së Administratës Doganore, ku në vijim marrëdhëniet e punës i janë rregulluar sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe me datë 25.01.2019, ka lidhur kontratë punë me DPD në pozicionin Drejtor i Antikontrabandës - Drejtoria e Antikontrabandës, pranë DPD-së, kontratë të cilën e ka nënshkruar me vullnetin e tij të lirë.
- Me datë 13.11.2020 është transferuar Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Antikontrabandës Detare në Drejtorinë e Antikontrabandës - DPD, ku marrëdhëniet e punës edhe në këtë pozicion rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës.
- Me vendim nr. 5172/1 prot., datë 17.03.2021 të punëdhënësit, ndodhur në kushtet e shkeljes prej tij të parimeve të mirëbesimit dhe integritetit, është vendosur 'Zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës'.

Lidhur me periudhën e punësimit të tij përgjatë viteve 2005-2013 në Gardën e Republikës si shoqërues i një prej drejtuesve të një partie politike, shprehemi se ky fakt është në funksion të karrierës së tij të punës dhe nuk është i lidhur aspak me rastin në fjalë, aq më shumë konsiderohet i pabazë dhe i verifikueshëm edhe pretendimi se largimi i tij nga puna është bërë për shkak se ai është pjesë e një partie politike.

Se dyti: Subjekti ankues, me datën 23.03.2021, i është drejtuar punëdhënësit të tij, G. G, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe disa drejtuesve të tjerë të administratës doganore, me një letër denoncuese administruar pranë institucionit me nr. 3702 prot., dt. 24.02.2021.

Nuk është i vërtetë pretendimi që kjo letër denoncuese nuk është marrë në konsideratë apo s'ka patur reagim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, pasi bazuar në nenin 7 të Kodit Doganor, i ndryshuar e për zbatim të përcaktimeve të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014 'Për personelin e administratës doganore', e ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme të DPD miratuar me Urdhër Nr.146, datë 07.05.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë:

- Pavarësisht faktit se M. L. në letrën denoncuese nr. 3702, prot., dt. 24.02.2021 ka deklaruar se është i gatshëm të ballafaqohet me këdo dhe kurdo për vërtetësinë e pretendimeve të parashtruara, në kundërshtim me deklarinimin e vet, ka ndërmarrë veprime për t'iu shmangur njoftimit/kërkesës për paraqitje para OPGJ-ve të Drejtorisë së Hetimit duke kërkuar lejen e zakonshme dhe duke paraqitur "Raport për paaftësi të përkohshme në punë"...me Nr. i rregj. 1056 (serie nr. 021424) dt. 02.03.2021, për periudhën 14 (katërmëdhjetë ditore) 03.03.2021-17.03.2021, brenda së cilës përfshihet edhe data 08.03.2021, si afat brenda së cilit duhet të paraqitet para OPGJ-ve. Madje ende deri më sot nuk është paraqitur pranë kësaj strukture. (bashkëngjitur e-mail).
- Në datë 03.03.2021, M. L. ka dërguar me e-mail në adresën elektronike të Drejtorit të Antikontrabandës dhe të Drejtorit të M.B. Njerëzore, Raportin Mjeksor për paaftësi të përkohshme në punë për 14 ditë (03-17 mars 2021), i aftë për punë 17.03.2021).

Siç edhe evidentohet në shkresën tuaj, M. L. ka dërguar informacionin denoncues edhe në struktura të tjera jashtë institucionit, duke tejkalluar rregullat e përcaktuara dhe duke mos

respektuar hierarkinë, veprime të cilat bien ndesh me përcaktimet e nenit 33 “Komunikimi në rrugë shkresore dhe elektronike”, të Rregullores së Brendshme të DPD, miratuar me Urdhër nr. 146, datë 07.05.2018 të MFE, si dhe nenet 9 dhe 16 të Kontratës së Punës nr. 2254 prot., datë 25.01.2019.

Në këtë e-mail, M. L. ndër të tjera ka parashtruar: “Do tju lutesha të më përfshinit dhe mua në kontrollin e subjektit si ish drejtues i kësaj strukture dhe si një person që ka kontrolluar vetë këtë subjekt”, kur ndërkohë sipas Raportit Mjekësor-Këshilla mjekësore është “Regjim shtrati”.

Vërehet kontradiktoritetet mes e-mail-eve të M. L., pasi ndodhemi në kushtet dhe rrethanat ku:

- nga njëra anë, në shkresën nr. 3702 prot., dt. 24.02.2021, pavarësisht se ka deklaruar që është i gatshëm të ballafaqohet me këdo dhe kurdo për vërtetësinë e pretendimeve të parashtruara, në kundërshtim me deklarin e vet, ka ndërmarrë veprime duke mos bashkëpunuar me strukturat hetimore si dhe për t’iu shmangur njoftimit/kërkesës për paraqitje para OPGJ-ve të Drejtorisë së Hetimit, duke kërkuar lejen e zakonshme dhe duke paraqitur “Raport për paaftësi të përkohshme në punë”, për periudhën 14 ditore, brenda së cilës përfshihet edhe data 08.03.2021 caktuar si afat për t’u paraqitur para OPGJ-ve;
- nga ana tjetër, brenda periudhës së paaftësisë së përkohshme ka parashtruar lutjen për t’u përfshirë në procedura kontrolli..., dhe deri më sot ende nuk rezulton të jetë paraqitur para OPGJ të Drejtorisë së Hetimit.
- në e-mail-in e datës 23.02.2021 dhe në shkresën nr. 3702 prot., dt. 24.02.2021, pretendimet e parashtruara nga M. L. lidhen me periudhën e fundvitit 2020, pretendime të cilat janë parashtruar rreth 2 muaj me vonesë, ndërkohë që mund t’ju njoftoheshin menjëherë strukturave hetimore të DPD, pa anashkaluar faktin që një prej detyrave të M. L. në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Antikontrabandës Detare, është vendosja përpara përgjegjësisë ligjore e të gjithë atyre subjekte që kryejnë veprimtari të paligjshme, shmangin apo fshehin mallra kontrabandë, apo çdo lloj trafik të paligjshëm.

Sa më sipër, ndodhur në këto kushte e rrethana, ku janë konstatuar shkelje të rënda nga ana e M. L. të neneve 33 dhe 76 të Rregullores së Brendshme të DPD, miratuar me Urdhër nr. 146, datë 07.05.2018 të MFE, dhe të detyrimeve e kushteve të përcaktuara në nenet 9 dhe 16 të Kontratës së Punës nr. 2254 prot., datë 25.01.2019, është bërë zgjidhja e marrëdhënieve të punës.

Referuar sa më sipër, del qartësisht në pah se vendimi për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës, jo vetëm që nuk lidhet me denoncimin e bërë nga ana e M. L. por përkundrazi është pasojë e shkeljeve si më lart nga ana e tij dhe shkeljeve të parimeve të mirëbesimit dhe integritetit....”.

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, DPD, nuk vuri në dispozicion të Komisionerit:

- E-mail/shkresa⁶ të shkëmbyera ndërmjet M. L. dhe përfaqësuesve të DPD-së, si më poshtë.

⁶ - Shkresë nr. 3702 prot., datë 24.02.2021 “Informim” (i njëjtë me e-mail dt. 23.02.2021);

- Mail dt.24.02.2021, “Për hetim urgjent”;

- Mail dt. 26.02.2021 “Njoftim paraqitje”;

- Mail dt.03.03.2021 “Njoftim raporti mjeksor” (drejtuar dr. A. K. dhe Dr. MBNJ)

- Njoftim nr. 8102 prot., datë 07.05.2021 “Njoftim për shpjegime”;

- Për periudhën 2019-2021, nuk rezulton të ketë denoncim nga punonjësit e DPD-së pranë eproveve të tyre për shkelje të kryera nga administrata e DPD-së.
 - Akte mbi procedurat e ndjekura mbi marrëdhëniet e tij të punës, dosje personale.
2. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës Nr. 632/3 prot., datë 17.06.2021 “*Njoftim për seancë dëgjimore*”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 06.07.2021. Gjithashtu, ditën e realizimit të seancës dëgjimore, Komisioneri kërkoi nga DPD, të vërë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes informacionin shtesë lidhur me shqyrtimin e ankesës së M. L.

Seanca u zhvillua në datën e caktuar, me praninë vetëm të palës ankuese, M. L.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

3. Duke qenë se nga ana e DPD-së nuk u paraqit asnjë përfaqësues në seancën dëgjimore të caktuar më datë 06.07.2021, me shkresën nr. 632/4 prot., datë 08.07.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi prej tyre, të vihet në dispozicion të shqyrtimit të çështjes informacion shtesë lidhur me shqyrtimin e ankesës së M. L.

Në përgjigje përsa më sipër, DPD, me anë të shkresës⁷ nr. 12558/4 prot., datë 01.07.2021, vuri në dispozicion të Komisionerit, përgjigjen e pjesshme, për shkak të kryerjes së lejes vjetore të disa nëpunësve dhe informoi lidhur me pyetjet e drejtuara nga subjekti ankues, ku ndër të tjera sqaroi se: “

- *Lidhur me pyetjen: A ka patur raste të vjedhjes së mjeteve dhënë personave, të cilët ligjërisht nuk duhet të kishin mjete?*

Automjetet në përdorim të personelit të administrates doganore, autorizohen bazuar në “Rregulloren e Brendshme për Administrimin e Automjeteve të Sistemit Doganor”, shkresa Nr. 28587/1, dt. 15.11.2019, i Drejtorit të Përgjithshëm, bashkëlidhur.

Në dijeninë tonë si Drejtori Buxhet & Financë nuk kemi patur raste të vjedhjes së mjeteve apo denoncime në organet përkatëse këtë qëllim.

- *Lidhur me pyetjen: A ka patur raste të dëmtimeve të mjeteve të doganave me pasoja të rënda dhe me vlera të mëdha (qindra mijëra euro) nga stafet doganore? Nëse ka patur, sa është vlera dhe dëmi i shkaktuar?*

Në dijeninë tonë si Drejtori Buxhet & Finance nuk kemi patur raste të mjeteve të doganave me pasoja të rënda dhe me vlera të mëdha (qindra mijëra euro) nga stafet doganore, duke ju bërë të

- Mail datë 06.05.2021 “Kërkesë për info”;

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 632/5 prot., datë 26.07.2021

ditur se të gjitha automjetet janë të siguara me TPL. Nuk kemi të dokumentuar për raste me vlera në dëme në qindra mijëra euro.

- Lidhur me pyetjen: A është në dijeni DPD, se ankuesi i ka kryer të gjitha shërbimet e mjetit tip Toyota (që ka patur në përdorim, përveç gomave , me të ardhurat e tij, pasi magazina nuk ka patur furnizim edhe pse në inventar ato janë tërhequr por kurrë me firmën e tij?

Me shkresën nr. 16281 prot., datë 19.06.2019 të Departamentit Administrativ M. L., është pajisur me automjetin TOYOTA, tip RAV 4, me targë AA675PN, dokumentuar nga magazina me FD nr. 851, dt. 20.06.2019. (bashkëngjitur)

Përsa i përket shërbimeve të automjeteve, në asnjë rast kërkesat për riparime dhe mirëmbajtje të automjeteve nuk autorizohen nga magazina e parkut të automjeteve. Shërbimet për riparimet e mirëmbajtjes së automjeteve konstatohen dhe autorizohen nga Drejtoria e Burimeve Mbështetëse në DPD, pranë Servisit të autorizuar konform kontratave të lidhura për këtë qëllim. Ky mjet është furnizuar nga magazina, me urdhër dorëzimi nga Drejtoria e Burimeve Mbështetëse, me artikujt...goma, vaj dhe filtra...”.

Gjithashtu, në përgjigje përsa më sipër, DPD, me anë të shkresës⁸ nr. 12558/6 prot., datë 01.07.2021, informoi Komisionerin lidhur me pyetjet e drejtuara nga subjekti ankues, ku ndër të tjera sqaroi se: “...Shërbimet për riparimet e mirëmbajtjes së automjeteve konstatohen dhe autorizohen nga Drejtoria e Burimeve Mbështetëse (grupi i punës i ngritur me urdhër nga eprori përkatës) në DPD, dhe pastaj shërbimet kryhen pranë servisit të autorizuar, konform kontratave të lidhura për këtë qëllim. Theksojmë se, pranë magazinës DPD tërhiqet vetëm vaji dhe pjesët e tjera, ndërrimet e zëvendësimet bëhen pranë servisit që ka fituar tenderin. Pas shërbimeve të kryera sipas akt-konstatimit të firmosur nga grupi i kontrollit dhe të portokolluar, plotësohet autorizimi për mjetin në fjalë, ku firmoset nga Zëvendësdrejtori Administrativ, portokollohet e vulozet, pastaj shkon mjeti në servis për shërbime dhe në përfundim të shërbimeve merret në dorëzim nga grupi i punës, ku në përbërje të të cilit është dhe drejtuesi i mjetit. Theksojmë se mjetit i janë bërë 3-4 shërbime në vite pranë serviseve me të cilët ka pasur kontratë DPD dhe të gjitha janë të plotësuara dhe dokumentuara. Në rastin konkret mjeti është marrë në dorëzim nga M. L. dhe pretendimet e ngritura se shërbimet janë kryer privatisht nuk qëndrojnë.

Për sa lart, deklarojmë se nga magazina e parkut në DPD, për këtë automjet (tip Toyota) me targë AA675PN, është bërë dalje vaj motorri 5-30, naftë, goma dhe bateri sipas nevojave e planit të shërbimeve që ka pasur mjeti, të konstatuara nga grupi i punës pranë DPD.”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

A/1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm, sa i përket procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

⁸ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1143 prot., datë 30.07.2021

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

- Ankuesi ka filluar marrëdhëniet e punës pranë Administratës Doganore me datë 17.10.2013, në detyrën Drejtor i Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit.
- Më ndatë 13.08.2014 është transferuar në detyrën Drejtor i Drejtorisë së Informacionit.
- Më datë 16.03.2015 është transferuar nga pozicioni i Drejtort të Drejtorisë së Informacionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në Specialist Analizë/Risku/Aposterior/Jurist Borxhi, pranë Degës Doganore Qafë Botë Sarandë.

Bazuar në vlerësim e rezultateve në individuale në punë (jokënaqshëm), si dhe rezultatet e trajnimit të detyrueshëm në përfundim të afatit të periudhës së proves, nuk është konfirmuar Nëpunës Civil (liruar nga shërbimi civil me Vendim Nr. 13467/1 prot., datë 04.06.2015). Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë, me vendimin e saj nr. 4747, datë 30.09.2015, lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vendosur ndër të tjera edhe: *“Rikthimin e M. L. në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Informacionit pranë DPD”*.

Në zbatim të vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Apelit Administrativ, ankuesi ka nënshkruar një deklaratë dhe ka pranuar punësimin e tij në një pozicion pune të së njëjtës kategori dhe në pamundësi në një kategori më të ulët brenda institucionit nga i cili është larguar, duke pranuar emërimin në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Operacioneve Doganore, dega doganore Morinë. Në këtë kuadër, me shkresën Nr. 7790/10, datë 20.11.2018, Departamenti i Administratës Publike, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, aktin e emërimit të ankuesit në pozicionin e pranuar prej tij.

Gjatë periudhës që ankuesi ka qenë në pritje për emërimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, i është drejtuar këtyre të fundit me shkresën datë 10.01.2019, protokolluar në të njëjtën ditë me nr. 572, në të cilën ka kërkuar ndër të tjera: *“...Duke marrë shkas nga CV dhe kontributet e mia në administratën shtetërore prej 14 vitesh, nëse do të jetë mundësia Ju lutem të rishikoni një pozicion tjetër me kategori A, me ose pa status të nëpunësit civil pranë DPD-së”*.

Në vijim, me urdhrin nr. 27949/2 prot., datë 25.01.2019, është emëruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në pozicionin Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Kukës (Morinë). Po në të njëjtën ditë, me Vendim nr. 2257 prot., datë 25.01.2019, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, ka vendosur: *“Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit civil, M. L., në detyrën Përgjegjës në Sektorin e Operacioneve Doganore në Degën Doganore Morinë, Kukës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”*.

Ligji nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, i ndryshuar, parashikon qartësisht rastet kur nëpunësi civil lirohet nga shërbimi civil. Për këtë, në nenin 66 të tij, parashikohet se:

1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon nëpërmjet lirimit në këto raste:

- a) për shkak të refuzimit të pajustificuar të nëpunësit për të pranuar transferimin e përhershëm, sipas neneve 50, 51 dhe 52 të këtij ligji;*

a/1) si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, sipas pikave 6 dhe 7, të nenit 50, të këtij ligji;

b) kur nëpunësi deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;

c) pas dy vlerësimeve “jokënaqshëm”, të rezultateve në punë;

ç) kur nëpunësi ushtron të drejtën për pensionin e reduktuar të pleqërisë, sipas ligjit;

d) kur nëpunësi civil gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë nëpunësi dhe, sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar apo nëse transferimi në një pozicion tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

dh) kur nëpunësi jep dorëheqjen nga detyra;

e) kur nëpunësi i nivelit të lartë drejtues anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e niveleve të tjera bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike;

e/1) në rast se anëtari i TND-së, i zgjedhur sipas pikës 5/1, të nenit 30, të këtij ligji, nuk përfundon me sukses trajnimin në ASPA;

e/2) në rastin e parashikuar nga neni 56 i këtij ligji;

e/3) në rast se vlerësohet përsëri “jokënaqshëm” në përfundim të procedurës së rivlerësimit, sipas pikës 2/1 të nenit 62;

ë) në çdo rast tjetër, të parashikuar nga ligji.

2. Anëtari i TND-së lirohet nga shërbimi civil kur nuk është caktuar në një pozicion të rregullt për të paktën 8 muaj në një periudhë 5-vjeçare;

3. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, në rastin e parashikuar sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij neni, konstatohet brenda 10 ditëve nga dhënia e vlerësimit të dytë “jokënaqshëm”, ndërsa në rastet e tjera brenda të njëjtit afat nga njohja e shkakut të lirimit.

4. Lirimi deklarohet me vendim të:

a) njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;

b) DAP-it për anëtarët e TND-së...” .

Nga informacioni i administruar dhe provat e vëna në dispozicion, në asnjë moment ankuesi nuk ka kërkuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, por rezulton që ai ka kërkuar emërimin në një pozicion pune të kategorisë A, me ose pa status të nëpunësit civil pranë DPD-së.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 2, datë 08.01.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për Personelin e Administratës Doganore”, të ndryshuar, përcaktohet se:

“I. a) Organika e administratës doganore është e përbërë nga:

i) Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

ii) Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Doganave;

iii) Drejtori i kabinetit;

iv) Nëpunës kategoria A;

v) Nëpunës kategoria B;

vi) Nëpunës kategoria C 1;

vii) *Nëpunës kategoria C 2;...*

b) *Funksionet dhe detyrat e personelit të administratës doganore janë, si më poshtë vijon:*

iv) *Nëpunës kategoria A.*

Në këtë kategori përfshihen: këshilltarë, drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, kryetar i Degës Doganore Tiranë, kryetar i Degës Doganore Durrës, kryetar i Degës Doganore Kukës, kryetar i Degës Doganore Kakavijë, kryetar i Degës Doganore Fier, kryetar i Degës Doganore Shkodër, kryetar i Degës Doganore Rinas.

Nëpunësit e kësaj kategorie, me funksionin këshilltar, kryejnë funksione këshillimore, si dhe mbështesin e ndihmojnë drejtorin e Përgjithshëm, sipas fushave specifike që mbulojnë, bashkërendojnë punën dhe bashkëveprojnë me strukturat e tjera.

Nëpunësit e tjerë të kësaj kategorie drejtojnë, bashkërendojnë, mbikëqyrin dhe sigurojnë administrimin e efektshëm të veprimtarisë së strukturës që drejtojnë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësive që i delegohen këtij posti.

v) *Nëpunës kategoria B*

Në këtë kategori përfshihen: përgjegjës sektori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, përgjegjës sektori në degët doganore, kryetar i një dege doganore që nuk është përshirë në përcaktimin e nënndarjes “iv”, më sipër.

Nëpunësit e kësaj kategorie drejtojnë, bashkërendojnë punën, mbikëqyrin dhe sigurojnë administrimin e efektshëm të veprimtarisë së strukturës që drejtojnë, si dhe ushtrojnë funksionet e përgjegjësive që i delegohen këtij posti....”

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar, evidentohet se pozicioni Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Kukës, i përket kategorisë B të nëpunësve të Administratës Doganore. Ndërsa, pozicioni që ankuesi ka mbajtur më parë dhe për të cilin Gjykata Administrative ka vendosur rikthimin në punë, si Drejtor i Drejtorisë së Informacionit pranë DPD, i përket kategorisë A të nëpunësve të Administratës Doganore. Në kushtet që ankuesit i është ofruar rikthimi në detyrë, ai ka pranuar emërimin në pozicionin Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Operacioneve Doganore, pranë Degës Doganore Kukës (Morinë), të një kategorie më të ulët në Administratën Doganore, nga ai që ka mbajtur përpara largimit.

Duke qenë se përpara largimit, ka mbajtur një pozicion pune që i përket kategorisë A të nëpunësve të Administratës Doganore, ka kërkuar që nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nëse do të ishte e mundur, të emërohej në të njëjtën kategori që ka mbajtur më parë, me ose pa status të nëpunësit civil. Në këtë kuptim, për asnjë moment ankuesi nuk ka kërkuar, si dhe nuk është përpara kushteve të përcaktuara në legjislacionin sipërcituar, për lirimin nga shërbimi civil.

Përsa më sipër, me Urdhrin nr. 2251 prot., datë 25.01.2019 “Për transferim të përkohshëm në detyrë”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka urdhëruar: “M. L., me detyrë Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Kukës, të transferohet me detyrë Drejtor, në Drejtorinë e Antikontrabandës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”. Në

këtë kuptim, ankuesi është emëruar në një pozicion pune që i përket kategorisë A të nëpunësve të Administratës Doganore. Për këtë, ka nënshkruar Kontratën Individuale të Punës me afat të pacaktuar, me nr. 2254 prot., datë 25.01.2019.

Referuar informacionit të administruar, ankuesi i është drejtuar me kërkesë padi (regjistruar më datë 15.01.2021), Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me nr. çështje 31138-00393-80-2021, me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur ti njohë Paditësit M. L. vijimësinë e statusit të “nëpunësit civil”, në kushte pezullimi, sipas, pikës 10, germa “c” dhe pikës 12, germa “c” VKM NR. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullim dhe lirim nga shërbimi civil”. Detyrimin e palës se paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore të këtij procesi.”*. Në këtë kuptim, ankuesi është në proces gjyqësor sa i përket përfundimit të marrëdhënies së punës si nëpunës civil.

Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur ndër të tjera:

1. *Pranimin e padisë së paditësit M. L.*
2. *Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme të Doganave t'i njohë paditësit M. L. vijimësinë e statusit të “nëpunësit civil”, në kushte pezullimi, si dhe detyrimin e kësaj Drejtorie të emërojë paditësin M. L. në pozicione të shërbimit civil, kategoria A, për shkak të mbarimit të periudhës dy vjeçare 25.1.2019- 25.1.2021 të largimit nga shërbimi civil.*
3. *Detyrimin e palës së paditur Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave t'i paguajë paditësit M. L. diferencën e pagës nga Kategoria “A” e statusit të nëpunësit civil si kategori e njohur me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe pagesës faktike të kryer për periudhën nga data 20.11.2018 e në vijim, gjithsej në masën 34.335 (tridhjetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e pesëmijë) lekë.*

Nga momenti i lirimit nga statusi i nëpunësit civil, marrëdhënia e punës ndërmjet ankuesit dhe punëdhënësit në pozicionet e punës në të cilat është emëruar/transferuar, është rregulluar mbështetur në parashikimet e Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, të ndryshuar.

Me Urdhrin nr. 10579 prot., datë 26.04.2019, ankuesi është transferuar përkohësisht për një periudhë të shkurtër, në detyrën Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm/Drejtor i Departamentit Operativo-Hetimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për t'u rikthyer në pozicionin e Drejtorit, në Drejtorinë e Antikontrabandës me Urdhrin nr. 10579 prot., datë 16.05.2019.

Më datë 13.11.2020 është transferuar Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Antikontrabandës Detare në Drejtorinë e Antikontrabandës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në vijim, ankuesi me shkresën nr. 3702 prot., datë 24.02.2021, i është drejtuar punëdhënësit të tij, Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe disa drejtuesëve të tjerë të administratës doganore, me një letër denoncuese për kontrabandën që bëhej në sistemin doganor shqiptar, kryesisht nga ana e strukturave të Antikontrabandës dhe Hetimit Doganor. Gjithashtu, ka garantuar gadishmërinë e tij për tu ballafaquar për vërtetësinë e këtij informacioni.

Nga informacioni i administruar, rezulton se Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, në të njëjtën ditë, pra me datë 24.02.2021, me anë të e-mailit i ka përcjellë Drejtorisë së Hetimit, informacionin e M. L. dhe i ka kërkuar : *“Të hetohet me urgjencë dhe precedencë! Të kryhet hetim i thelluar për të gjitha pretendimet, të nxirren përgjegjësitë administrative dhe penale për personat përgjegjës! Të informohem çdo ditë për ecurinë e hetimeve”*.

Drejtoria e Hetimit në funksion të shkresës nr. 3702 prot., datë 24.02.2021, kanë nisur menjëherë procedurat e verifikimit/hetimit, mbi këtë informacion dhe bazuar në nenin 275⁹ të Kodit Doganor, me anë të e-mailit datë 26.02.2021, kanë njoftuar/kërkuar paraqitjen brenda datës 08.03.2021, pranë hetuesve Doganor të Drejtorisë së Hetimit të M. L., si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit/verifikimit për rastin e sipërcituar.

Në të njëjtën ditë, në përgjigje të e-mailit të sipërcituar, ankuesi ka kthyer përgjigje, duke sqaruar se: *“...Deponimet e mia dhe çdo gjë tjetër në lidhje me punën time do e vë në dispozicion të SPAK. Me ju si djetori hetimi për rastin konkret kam konflikt interesi, pasi kjo nuk është hera e parë që unë shkruaj dhe ju smë keni thërritë. Pse e bëni tani? A jeni në dijeni të një shkrese tjetër me të njëjtën përmbajtje?...”*. Pasi Drejtoria e Hetimit është vënë në dijeni të e-mailit të përcjellë nga ankuesi, nuk ka kthyer përgjigje lidhur me pyetjet e parashtruara prej tij.

Në vijim, rezulton se ankuesi ka kërkuar nga ana e punëdhënësit, të shfrytëzojë lejen e zakonshme, e cila nuk i është miratuar me arsyetimin e përcjellë me e-mail datë 01.03.2021, duke i sqaruar se: *“Duke marrë shkas nga situata e krijuar në vend për shkak të infeksionit të shkaktuar nga virusi COVID-19, në kushtet kur:*

- kemi mungesa në staf, punonjës të Drejtorisë së AK që rezultojnë të dyshuar apo të infektuar nga virusi,
- puna e zhvilluar me grafik e cila për pasojë ka sjellë akumulim dhe mbingarkesë në punë, rrethana të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në proceset e përditshme dhe ecurinë e veprimtarisë së drejtorisë, lutemi mirëkuptoni pamundësinë objektive për të miratuar kërkesën tuaj për leje të zakonshme për periudhën 01-21.03.2021, për arsyet e sipërcituara.”

Nga ana e ankuesit, më datë 03.03.2021, me anë të e-mailit është dërguar pranë punëdhënësit raporti mjeksor për paaftësi të përkohshme në punë, nga data 03.03.2021-17.03.2021, i aftë për punë më datë 17.03.2021.

⁹ Neni 275, Marrja e dëshmime/deklarimeve, parashikon se:

1. Autoritetet doganore mund të marrin në pyetje shkelësin dhe/apo dëshmitarët. Për këtë qëllim autoritetet doganore duhet t'u bëjnë atyre një njoftim, në të cilin përcaktohen data dhe ora, në të cilën duhet të paraqiten personalisht ose duhet të depozitohen një dëshmi/deklarim me shkrim. Afati kohor për t'u paraqitur për këtë qëllim nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë. Në rastet e flagrancës, marrja në pyetje e shkelësve dhe dëshmitarëve bëhet menjëherë. Konsiderohen, gjithashtu, dëshmitarë të gjithë ata persona që mund të jenë bashkëpunëtorë në shkelje, si dhe vetë punonjësi ose nëpunësi i doganës që ka verifikuar shkeljen dhe ka nënshkruar procesverbalin.

2. Në rastet kur shkelësi dhe dëshmitarët marrin pjesë personalisht në marrjen në pyetje, dy punonjës të autorizuar të doganës drejtojnë seancën e marrjes në pyetje dhe përgatitin raportin përkatës.

3. Dëshmitë/deklarimet duhet të nënshkruhen nga shkelësi e nga dëshmitarët, kur janë të pranishëm, dhe nga të dy punonjësit e doganës që kanë drejtuar seancën e marrjes në pyetje...

Nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore janë ndërmarrë procedurat përkaëse për konfirmimin/vërtetësinë dhe ligjshmërinë e dokumentit të lëshuar “Raport për paaftësi të përkohshme në punë” me Nr. rregj 1056 (serie nr.021424) datë 02.03.2021 të lëshuar nga Instituti Shëndetësor Nr. 1 Tiranë. Për këtë rast i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë me shkresë, por që nuk kanë marrë asnjë përgjigje.

Ankuesi më datë 04.03.2021, me e-mail, duke u referuar përmbajtjes së shkresës nr. 3702 prot., datë 24.02.2021, i është drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe 2 (dy) drejtuesve të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke i vënë në dijeni për kontrabandën që bëhej në sistemin doganor shqiptar.

Përsa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ditën që ankuesi është kthyer në punë nga përfundimi i raportit për paaftësi të përkohshme në punë, me vendim nr. 5172/1 prot., datë 17.03.2021, është vendosur për: *“Zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të M. L. më detyrë Përgjegjës Sektori, Sektori i Antikontrabandës Detare në Drejtorinë e Antikontrabandës, pranë Departamentit Operativ Hetimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”*, për shkak të shkeljes nga ana e tij, të parimeve të mirëbesimit dhe integritetit.

Komisioneri vlerëson se, marrëdhëniet kontraktuale ndërmjet punëmarrësit/ankuesit dhe punëdhënësit/Drejtorisë e Përgjithshme e Doganave, i nënshtrohen përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë këtë marrëdhënie.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar bazën ligjore në të cilën është mbështetur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, kur ka justifikuar ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës me subjektin ankues.

Drejtorisë e Përgjithshme e Doganave largimin e ankuesit nga puna e ka bazuar tek Kodi i Punës, në nenin 153, pika 2 të tij, e cila ka përcaktuar se: *“Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënies së punës”*.

Po ashtu, edhe tek neni 12, i Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku është parashikuar se:

“Administrata doganore shqiptare udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, qëndrueshmërisë në detyrë dhe vazhdimësisë në karrierë, integritetit, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e ligjit.”

Kodi i Punës, si dhe Kontrata Individuale e Punës, e cila në kuptim të përcaktimit të detyrimeve dhe gëzimit të të drejtave ndërmjet palëve kontraktuale ka fuqinë e ligjit, kanë përcaktuar në

mënyrë të detajuar rastet se kur mund të zgjidhet në mënyrë të menjëhershme kontrata e punës nga punëdhënësi.

Neni 37, i Kodit të Punës “Masa disiplinore”, ka specifikuar se:

“Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore. Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm”.

Neni 9 “Detyrimet e punëmarrësit”, i Kontratës Individuale të Punës mes ankuesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ka përcaktuar se:

- “ 1. Punëmarrësi kryen personalisht dhe me kujdes punën e ngarkuar.*
- 2. Punëmarrësi respekton urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme e te veçanta të punëdhënësit. Punëmarrësi nuk është i detyruar që zbatojë urdhrat dhe udhëzimet e punëdhënësit, të cilat ndryshojnë kushtet e kontratës së punës, si dhe kur këto urdhra rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tij dhe janë në kundërshtim të hapur me ligjin.*
- 3. Punëmarrësi ka detyrimin të zbatojë të gjitha detyrat e përcaktuara posaçërisht në Rregulloren e Brendshme të DPD dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që normojnë punën e administratës doganore.*
- 4. Punëmarrësi, për kryerjen e punës, duhet përdorë sipas rregullave të caktuara mjetet e punës dhe pajisjet e vëna në dispozicion të tij. Punëmarrësi nuk duhet të përdorë mjetet e punës për përfitime private.*
- 5. Punëmarrësi i jep llogari punëdhënësit për gjithçka të përfituar në emër të punëdhënësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij brenda kontratës.*
- 6. Punëmarrësi ruan me besnikëri interesat e ligjshme të punëdhënësit.*
- 7. Gjatë vlefshmërisë së kontratës, punëmarrësi nuk duhet të kryejë asnjë punë të paguar nga të tretët, e cila dëmton punëdhënësin ose i bën konkurrencë atij.*
- 8. Gjatë vlefshmërisë së kontratës dhe pas mbarimit të saj, punëmarrësi duhet të ruajë faktet e destinuara të mbeten konfidenciale apo sekret.*
- 9. Punëmarrësi duhet të respektojë orarin e punës dhe të mos largohet nga vendi i punës pa miratimin e eprorit të tij.*
- 10. Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia.*
- 11. Punëmarrësi, për nevoja urgjente, pranon të transferohet në vende pune apo detyra të tjera të ngjashme, brenda fushës së aktivitetit administrativ të Punëdhënësit. Gjatë periudhës së transferimit, punëmarrësi paguhet me pagën e pozicionit të punës të përcaktuar në këtë kontratë.*
- 12. Punëmarrësi, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës, numrit të telefonit dhe adresës elektronike të tij, detyrohet të njoftojë Punëdhënësin. Shkelja e këtij detyrimi i bën të papranueshme pretendimet e Punëmarrësit për pavlërsueshmëri të njoftimeve të Punëdhënësit.”.*

Neni 13 “Masat disiplinore”, ka përcaktuar se:

1. Në rast të konstatimit të shkeljeve disiplinore në punë, moszbatimit të Rregullores së Brendshme të Institucionit, Kodit të Etikës, Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe akteve të tjera në zbatim të tij, Punëmarrësi do t'i nënshtrohet marrjes së masave disiplinore sipas rregullave në fuqi.
2. Masat disiplinore jepen duke vlerësuar shkeljen e kryer, shkallën e përgjegjësisë, si dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes. Ndaj punëmarrësit mund të merren këto masa disiplinore:
 - a. Për shkelje të lehta të disiplinës:
 - I. Këshillim (Vërejtje me gojë).
 - II. Vërejtje me shkrim.
 - b. Për shkelje të rënda të disiplinës:
 - I. Gjorbë që nuk kalon pagën e 5 (pesë) ditëve të punës së punëmarrësit.
 - II. Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna.
 - III. Largim nga puna (Zgjidhje e kontratës së punës).
3. Konsiderohet shkelje e lehta e disiplinës:
 - a. moszbatimi i orarit të punës 30 minuta në ditë;
 - b. mungesa në punë një ditë;
 - c. largimi pa leje nga vendi i punës për periudha të shkurtra.
 - d. sjellja jo korrekte me kolegët, eprorët dhe të tretët gjatë orarit të punës dhe jo të përsëritura.
4. Konsiderohet shkelje e rëndë a disiplinës:
 - a. moszbatimi i përsëritur i orarit të punës 30 minuta në ditë;
 - b. mungesat e përsëritura të pajustificuara në punë deri në tre raste. me gjithë paralajmërimet e herëpashershme të punëdhënësit;
 - c. shkaktimi i dëmit material me dashje ose nga pakujdesia;
 - d. shkelje të detyrimeve të përcaktuara të pikat 3, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të nenit 9, të kësaj kontrate.
 - e. shkelje të përsëritura të detyrimeve të përcaktuara në nenet e kësaj kontrate.

Neni 16 “Konfidencialiteti, Informacione, Pronësia Intelektuale”, ka përcaktuar se:

1. Punëmarrësi duhet të ruajë rigorozisht sekretet e punës si gjatë ashtu dhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, sekrete dhe dijeni këto që lidhen me veprimtarinë e Punëmarrësit dhe që Punëmarrësi ka përfituar gjatë marrëdhënies së punës.
2. Të gjitha dokumentat, shkresat, të dhënat teknike apo informacionet a tjera që Punëmarrësi zotëron gjatë marrëdhënies së punës, duhet të mbeten në pronësi të vetme dhe ekskluzive të Punëdhënësit.

3. *Punëmarrësi, nëpërmjet kësaj Kontrate njeh dhe pranon që çdo lloj pronësie intelektuale apo e drejtë mbi pronësinë intelektuale, të zbuluara, krijuara apo përfituara gjatë aktivitetit/ marrëdhënies së punës, janë në pronësi ekskluzive të Punëdhënësit. Punëmarrësi është i detyruar të njoftojë menjëherë Punëdhënësin mbi të gjitha hollësitë dhe rezultatet e punës së tij.*

Lidhur me argumentat e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, Komisioneri vlerëson se nuk qëndrojnë, dhe se, referimi tek baza ligjore e cituar në vendimin për largimin e tij nga puna, është i gabuar dhe i keqzbatuar në këtë rast, për arsyet poshtëcituar:

- Në aktet e mësipërme që normojnë marrëdhënien juridike të punës mes ankuesit dhe punëdhënësit, nuk është e parashikuar dhe e përcaktuar se denoncimi i akteve korruptive në sistemin doganor tek punëdhënësi apo në struktura të tjera ligjzbatuese përbën shkelje disiplinore.
- Pavarësisht këtij fakti, bazuar në përcaktimet e nenit 16, të Kontratës Individuale të Punës, Komisioneri konstaton se, rasti i pretenduar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kundrejt ankuesit, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikura në këtë Kontratë, që sipas përcaktimit të saj të mund të quhej shkelje disiplinore, mbi bazën e të cilës, më pas mund të ndërmerrej dhe masa disiplinore përkatëse, për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.

Dhënia e masave disiplinore është pjesë e mjeteve ligjore për mbrojtjen e punëdhënësit, në rastet kur punëmarrësi nuk i respekton rregullat dhe normat kontraktore dhe ligjore. Masat disiplinore duhet të jepen duke respektuar parimin e proporcionalitetit, që parashikon se për një shkelje të lehtë, duhet të jepet masë disiplinore e lehtë e më tej duke u përshkallëzuar. Masa disiplinore duhet të dokumentohet, të materializohet dhe t'i bëhet me dije punëmarrësit në kohën kur jepet, sepse ai ka të drejtën e ankimit ndaj masës, si dhe për faktin se masat disiplinore më të lehta parashkruhen me kalimin e afateve të caktuara ligjore.

Në rastin konkret, nuk jemi përpara materializimit të një mase disiplinore kundrejt ankuesit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pasi “*de jure*” nuk ka një procedurë ligjore të ndjekur lidhur me ecurinë disiplinore ndaj tij.

Në rast se do të kishte ndjekur një procedurë të tillë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duhet të kishte patur në konsideratë zbatimin e parimit të kontradiktoritetit, si një garanci që punëmarrësit duhet t'i ishin krijuar mundësitë për t'u mbrojtur efektivisht për kundërshtimin e masës së dhënë ndaj tij.

Shkelja e këtij parimi përbën shkelje të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, qëndrim ky i konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 69, datë 16.10.2000 të saj, ka mbajtur qëndrimin se: “*Parimi i kontradiktoritetit lidhet e me të drejtën e palëve për t'u dëgjuar, për t'i bërë të njohur njëra*

tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara, referencën e saktë ligjore”.

Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Nenin 10/1, parashikon mbrojtje për punonjësit që denoncojnë korrupsionin, duke përcaktuar se:

“1. Çdo masë ose sanksion administrativ i pajustificuar, që është marrë ndaj punonjësve, të cilët kanë arsye të dyshojnë për korrupsion e që këtë dyshim ua paraqesin personave përgjegjës ose autoriteteve kompetente, është i pavlefshëm.

2. Kundër vendimit të dhënë në mënyrë të pajustificuar për shkakun e mësipërm, punonjësi ka të drejtën e ankimit në gjykatë.

3. Raportimi i fakteve, që kanë lidhje me korrupsionin, nuk përbën shkelje të detyrimit të sekretit profesional”.

Gjithashtu, Ligji Nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, në nenin 18 të tij parashikon se:

“1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) shkarkimin nga puna;*
- b) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;*
- c) transferimin brenda ose jashtë organizatës;*
- ç) uljen në detyrë;*
- d) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;*
- dh) humbjen e statusit dhe të privilegjeve;*
- e) mosngritjen në detyrë;*
- ë) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;*
- f) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;*
- g) forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.*

2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.

3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të organizatës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast të kundërt, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, i drejtohet organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik ose urdhëron subjektin privat të marrë të gjitha masat, sipas këtij neni. Nëse organi kompetent ose subjekti privat nuk merr masat e kërkuara nga ILDKPKI-ja, çdo person i interesuar ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës.”

Përsa më sipër, fakti që ankuesi ka vënë në dijeni punëdhënësin për aktet korruptive nga strukturat doganore të Antikontabandës dhe Hetimit Doganor, veç të tjerash duhet të kishte një mbrojtje të veçantë dhe jo ti ndërpritej kontrata e punës në mënyrë të menjëhershme apo të mos i jepej e drejta

për t'u dëgjuar dhe për t'i bërë të njohur mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre.

Ligji Nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”, në nenet 12 dhe 13 të tij parashikon në mënyrë të qartë parimet e përgjithshme të hetimit administrativ dhe procedurat e hetimit administrativ. Më saktësisht në Nenin 12 parashikohet se:

1. Në kryerjen e funksioneve të saj, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja duhet:
 - a. të veprojë me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitimë të sinjalizuesit;
 - b. të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave, sipas këtij ligji;
 - c. të shmangë çdo konflikt interesi të mundshëm dhe të deklarojë menjëherë tek organizata ose ILDKPKI-ja konfliktin e interesit përpara fillimit të hetimit administrativ të një sinjalizimi;
 - ç. të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
 - d. të ruajë konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi, në përputhje me nenet 15 dhe 16 të këtij ligji;
 - dh. të ruajë sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi në zbatim të ligjit.
2. Gjatë procesit të hetimit administrativ, sinjalizuesi ka të drejtë të mos zbulojë burimet e informacionit.

Ndërsa në Nenin 13, përcaktohet se:

1. Sipas rastit, çdo njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë ligj. Për aq sa nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësia përgjegjëse pranë autoritetit publik dhe ILDKPKI-së zbatojnë dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Procedura e hetimit administrativ të sinjali-zimit përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
3. Gjatë periudhës së hetimit administrativ, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Për këtë qëllim, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklaratat ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
4. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjali-zuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuarat, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga drejtuesi i hetimit.
5. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:

- a) mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
- b) mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
- c) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij... ”.

Në kushtet që ankuesi, i është drejtuar punëdhënësit, se strukturat vartëse të tij janë përfshirë në akte korruptive, nuk duheshin marrë masa në formë hakmarrje¹⁰, por duhej hetuar informacioni i dhënë duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm. Fakti që nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i është përcjellë për hetim informacioni i dhënë nga subjekti ankues, strukturave të cilat akuzoheshin drejtpërdrejtë për akte korruptive, ka bërë që ankuesi të humbë besimin ndaj punëdhënësit dhe t'i drejtohet strukturave të tjera ligjzbatuese.

Lidhur me referimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në vendimin për largimin nga puna të ankuesit, ku pretendohet për *zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të shkeljes nga ana e tij, të parimeve të mirëbesimit dhe integritetit*, Komisioneri vlerëson se është i pabazuar dhe i padrejtë, pasi, nuk mund të konsiderohet shkelje e parimeve të mirëbesimit dhe integritetit, një fakt që nuk është hetuar dhe provuar më parë si *shkelje*.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në rastin konkret, nuk ka hetuar apo provuar faktin që ankuesi ka paraqitur informacion të pabazuar apo të pavërtetë sa i përket denoncimit të korrupsionit të strukturave doganore. Nëse do të kishte hetuar më parë dhe dalë në konkluzionet e sipërcituara, mund të kishte iniciuar procedurën për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkeljes së parimeve të mirëbesimit dhe integritetit.

Komisioneri gjykon se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka arritur të provojë pretendimet e saj se informacionet e dhëna, drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë apo Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, sa i përket akteve korruptive në strukturat doganore, përbëjnë shkelje të rëndë apo shkak për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me subjektin ankues.

Në përfundim, bazuar në analizimin e veprimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kundrejt M. L., bazës ligjore tek e cila janë referuar masa kundrejt tij, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të pafavorshëm dhe të padrejtë për sa i takon ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me të.

A/2. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm, sa i përket shërbimeve të mirëmbajtjes së automjetit që ankuesi kishte në përdorim.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, M. L. ka parashtruar se gjatë kohës që ka ushtruar detyrën në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, ka patur në përdorim një mjet tip Toyota. Një ndër ditët, në të cilat ka qenë duke ushtruar detyrën, xhami i parë i mjetit është goditur nga një gurë, i cili ka krijuar një krisje në të. Sipas ankuesit, për këtë ngjarje, ai ka qenë personi i vetëm i cili është ngarkuar me sanksion me gjobë prej 300 Euro nga punëdhënësi për dëmtimin e xhamit të

¹⁰ Referuar në parashikimin e Nenit 18 të Ligjit Nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

automjetit. Gjithashtu, ka pretenduar faktin që edhe pse ka patur punonjës të cilëve u është vjedhur apo dëmtuar mjete që kishin në përdorim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ndaj tyre nuk është marrë asnjë masë.

Nga informacioni i administruar, Komisioneri u informua nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave se në dijeninë e tyre nuk kanë patur raste të mjeteve të dëmtimit të mjeteve me pasoja të rënda dhe me vlera të mëdha nga stafet doganore, duke bërë të ditur se të gjitha automjetet janë të sigurara me TPL.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, me Urdhrin Nr. 42, datë 15.11.2019, ka miratuar Rregulloren e Brendshme për Administrimin e Automjeteve të Sitemit Doganor. Në përmbajtje të saj, Komisioneri nuk arriti të evidentojë asnjë parashikim apo referencë, sa i përket zhdëmtimit nga ana e përdoruesit të mjetit në rast të aksidenteve apo defekteve të mjetit gjatë lëvizjes.

Në nenin 11 “*Veprimet në rast të aksidenteve*”, të Rregullores së Brendshme për Administrimin e Automjeteve të Sitemit Doganor, parashikohet:

Në rastet kur një automjet zyrtar është i përfshirë në aksident, drejtuesi i automjetit vepron si më poshtë:

- a. ndal automjetin dhe qëndron në vendin e aksidentit deri në arritjen e autoriteteve policore ose në kryerjen e të gjitha procedurave të rmëposhtme, përveç rasteve kur është në rrezik integriteti (siguria) e tij,*
- b. ofron ndihmën e parë personit të lënduar nëse ai është në gjendje ta bëjë këtë,*
- c. raporton aksidentin menjëherë nëse ka mundësi përmes telefonit Drejtorin e Burimeve Mbështetëse ose pas arritjes në vendin e punës;*
- d. në rast të lëndimit të palës së tretë ose pronës, përveç hapave të mësipërm, drejtuesi duhet të informojë strukturat e policisë drejtpërdrejtë apo nëpërmjet institucionit.*
- e. nuk duhet të marrë asnjë zotim në lidhje me përgjegjësinë, duke ua lënë atë autoriteteve policore.*

Në nenin 12 “*Veprimet në rast të emergjencave/defekteve të automjetit gjatë lëvizjes*”, të Rregullores së Brendshme për Administrimin e Automjeteve të Sitemit Doganor, parashikohet:

Në rastet kur një automjet zyrtar gjatë lëvizjes pëson një defekt/avari, drejtuesi i automjetit vepron si më poshtë:

- a. raporton defektin/avarinë menjëherë tek Drejtori i Burimeve Mbështetëse ose personi i autorizuar prej tij.*
- b. me marrjen e miratimit nga Drejtori i Burimeve Mbështetëse, ose personi i autorizuar prej tij, sipas rastit:*
 - i. dërgon automjetin në servis në më të afërt për të kryer riparimin në kushte të emergjencës, duke mbajtur më parë Procesverbalin e konstatimit të defektit.*
 - ii. parkon automjetin në stacionin më të afërt duke mbajtur më parë Procesverbalin e konstatimit të defektit dhe njofton Drejtorin e Burimeve Mbështetëse ose personin e*

autorizuar prej tij për mundësimin e një karroatreçi për dërgimin e automjetit pranë ambjenteve të ofiçinës së parkut DPD.

Përsa më sipër dhe në analizë të Rregullores së Brendshme për Administrimin e Automjeteve të Sitemit Doganor, nuk konstatohet asnjë parashikim sa i përket dëmshpërblimit nga ana e punëmarrësit/përdoruesit të mjetit apo sanksion me gjobë, në rast të aksidenti apo defekti të automjetit në përdorim. Nga informacioni i dhënë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me shkresën nr. 12558/3 prot., datë 19.07.2021, *të gjitha automjetet janë të siguara me TPL.*

Në këtë kuptim dhe në interpretim të informacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, evidentohet se në rast të dëmtimit të mjetit si pasojë e një aksidenti apo defekti, nuk është përdoruesi i mjetit/nëpunësi i cili ka detyrimin të riparojë mjetin apo të dëmshpërblejë punëdhënësin për dëmin e shkaktuar, në formë sanksioni, por strukturat përgjegjëse dhe ofiçina e parkut të DPD-së.

Në përfundim, bazuar në analizimin e veprimeve të Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave kundrejt M. L., Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar para një trajtimi të pafavorshëm dhe të padrejtë përsa i takon sanksionit me gjobë lidhur me dëmtimin e mjetit që kishte në përdorim.

B. Shkaku i mbrojtur.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Neni 1, i ligjit, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “*për çdo shkak tjetër*”.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “*shkakun e mbrojtur*”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin,*

gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

B/1. Bindja politike

- *"Bindja politike"* si shkak diskriminimi, sipas ankuesit nënkupton faktin që në vitet 2005-2013, ka ushtruar detyrën e punonjësit të Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërues i një prej drejtuesëve të lartë të Partisë Demokratike, por nuk ka qënë asnjëherë anëtarë i ndonjë subjekti politik. Gjithashtu, në vitin 2013, gjatë fjalës së mbajtur në Kuvendin e Shqipërisë, nga ana e një prej drejtuesve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, është cituar se: *"...kemi marrë në punë si drejtor të antikontrabandës M. L., shoqëruesin e J. T. të Partisë Demokratike"*.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9¹¹ të tij *"Ndalimi i diskriminimit"*, parashikon *"bindjet politike"* si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : *"Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim "*, nuk lind nevoja për verifikim.

Nga informacioni¹² i administruar në media, rezulton se më datë 29.05.2014, në foltoren e Kuvendit të Shqipërisë, deputeti i Partisë Socialiste T. B., i është drejtuar ish Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, J. T., duke i thënë se: *"...Të nderuar zotërinj, drejtori aktual i antidrogës, M. L. ka qënë bodigard i zonjës J. T. dhe mik i shtëpisë së saj. Ai ka qënë drejtor i shërbimit të policisë rrugore deri në vitin 2013 dhe është sot përgjegjës i antidrogës sepse modeli jonë nuk bën përjashtime demokrat ose jo."*

¹¹ Me "diskriminim" kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

¹² <https://dosja.al/cpo-ndodh-ne-ps-ish-bodigardi-i-j.-t.-merr-postin-e-drejtorit-te-anti-kontrabandes-kush-eshte-m.-l./>
https://www.tpz.al/2019/05/20/ish-bodigardi-i-j.-merr-postin-e-drejtorit-te-anti-kontrabandes-kusheshte-m.-l./?fbclid=IwAR0imyimynfNMXQ0PCOH44B4c-C8cidk2ICr-h2_CBD8szJwm3e-K9sbrA
<https://dosja.al/dikur-ruante-jozefina-topallin-kush-eshte-drejtori-i-anti-kontrabandes-qe-u-kercenua-vartesi-malesor-me-sms-m.-l.-pushka-tu-befte-top/>
<https://www.dailymotion.com/video/x32kj63>
<https://www.oranews.tv/topalli-ne-antikontrabande-persona-ne-kerkim-balla-eshte-ish-bodigardi-yt>

Bazuar në parashtrimet e ankuesit, Komisioneri vlerëson se jemi në situatën kur shkakun e mbrojtur e mbart personi me të cilin subjekti ankues shoqërohet apo supozohet se shoqërohet, parashikuar në nenin 3¹³, pika 4 e LMD-së. Ky pretendim i përket formës së “*diskriminimit për shkak të shoqërimit*”, parashikuar në këtë ligj. Në rastin konkret, bindjet politike të pretenduara nga ankuesi, mbarten nga personi J. T., ish funksionare e Partisë Demokratike dhe përfaqësuese e këtij subjekti politik në pozicionin e ish Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë¹⁴ në vitet 2005-2013.

Referuar informacionit të sipërcituar, rezulton se ankuesi është evidentuar publikisht si anëtarë i subjektit politik të Partisë Demokratike për shkak të faktit që ka qenë shoqërues i ish Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë.

B/2. Çdo shkak tjetër

- Gjatë parashtrimeve të tij, ankuesi ka pretenduar diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”, duke argumentuar dhe provuar se trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm ndaj tij, ka filluar pas denoncimit lidhur me korrupsionin e ushtruar nga strukturat doganore, deri në largimin e tij nga puna.

Rezulton se më datën 23.02.2021 nëpërmjet e-mailit dhe me shkresën nr. 3702 prot., datë 24.02.2021, i është drejtuar punëdhënësit të tij, G. G, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe disa drejtuesve të tjerë të administratës doganore, me një letër denoncuese për kontrabandën që bëhej në sistemin doganor shqiptar. Pak kohë më pas, me të njëjtën përmbajtje, me e-mail, i është drejtuar edhe Drejtorit të Kriminologjik në Policinë e Shtetit dhe Zëvendës Drejtorit të Policisë Tiranë.

Në çështjen në shqyrtim, shkakun e pretenduar nga ankuesi “*për shkak denoncimeve për kontrabandën e kryer në sistemin doganor shqiptar*”, nuk është një shkak që parashikohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë si shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Në mënyrë që ankuesi të pretendojë diskriminim për shkakun e pretenduar, duhet të provohet se ai gëzon ndonjë “shkak tjetër”, në kuptim të nenit 1, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Për të vlerësuar nëse shkakun e pretenduar gëzon mbrojtje nga parashikimi “*për çdo shkak tjetër*”, Komisioneri do të mbajë në konsideratë praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut¹⁵, në drejtim të interpretimit të shkaqeve/statuseve të tjera sipas nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut¹⁶.

¹³ Në të cilin parashikohet se: “*Diskriminim për shkak të shoqërimit*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

¹⁴ https://sq.wikipedia.org/wiki/Jozefina_Topalli

¹⁵ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën GJEDNJ.

¹⁶ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KEDNJ.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme, objektive ose personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.¹⁷ Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.¹⁸ Gjykata fillimisht vëren që ndërsa një numër i shembujve konkretë kanë të bëjnë me karakteristikat që mund të thuhet se janë “*personale*” në kuptimin që ato janë karakteristika të lindura ose të lidhura natyrshëm me identitetin ose personalitetin e individit, të tilla si seksi, raca dhe feja, jo të gjitha shkaqet e listuara mund të karakterizohen kështu.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; Në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; Në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit i *burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; Në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, përsëri Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; Në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhet nga skema e lirit të parakohshëm midis *personave që vuanin dënime afatgjata të përcaktuar me 15 vjet ose më shumë dhe atyre që vuanin dënime afatgjata të përcaktuar me më pak se 15 vjet ose dënime të papërcaktuara*.

Në çështjen *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar* (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Komisioneri, në praktikën e tij ka konstatuar diskriminim si rezultat i trajtimit diferencues dhe më pak të favorshëm në lidhje me reduktimin e pagës midis grupeve/kategorive të ndryshme të punonjësve nga ana e punëdhënësit dhe konkretisht midis *grupit të punonjësve të administratës dhe grupit të punonjësve të terrenit*¹⁹. Gjithashtu, ka konstatuar sjellje diskriminuese si pasojë e trajtimit të diferencuar që iu bëhet punonjësve të policisë së burgjeve që kanë *statusin e punonjësit në periudhë prove*, të cilëve nuk iu ofroheshin të njëjtat garanci procedurale sikundër punonjësve të tjerë të cilët e kishin kaluar periudhën e provës.²⁰ Komisioneri ka konstatuar edhe sjellje

¹⁷ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70.

¹⁸ Shih: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

¹⁹ Shiko: *Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptar kundër Albpetrol sh.a*, Vendimi nr. 107, datë 11.09.2020, i Komisionerit.

²⁰ Shiko: *M.Gj kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve*, Vendimi nr.157, datë 03.11.2020, i Komisionerit.

diskriminuese si pasojë e trajtimit të diferencuar që i bëhet një punonjësi për shkak të denoncimeve kundër punëdhënësit.²¹

Bazuar në nenin 9/2 të Kodit të Punës, mbrojtja nga diskriminimi garantohet bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar se: *“Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”*

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, pretendimi i ankuesit se diferenca në trajtim për shkak të denoncimeve për kontrabandën e kryer në sistemin doganor shqiptar, gëzon mbrojtje bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, pasi bazohet në një karakteristikë të identifikueshme dhe objektive, ankuesi mbart *“shkakun tjetër”* dhe Komisioneri e ka pranuar si shkak të mbrojtur, sipas parashikimit të nenit 1 të ligjit.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sa i takon: ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe sanksionit me gjobë lidhur me dëmtimin e mjetit që kishte në përdorim.

Nga ana e shoqërisë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin që largimi i ankuesit nga puna, kishte ardhur për arsye objektive të justifikuar.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

²¹ Shiko: V. H. kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a., Vendimi nr. 113, datë 26.08.2019, i Komisionerit

Shiko: F. B. kundër Qendrës Spitalore Universitare të Traumës, Vendimi nr. 176, datë 02.11.2019, i Komisionerit

Doktrina kushtetuese, e trajton të drejtën e individit për punë, duke theksuar se liria për punë mbrohet nga rregullimet kushtetuese.²²

Gjykata Kushtetuese²³, ka mbajtur qëndrimin se: *“E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës.”*

Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi.

E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit.

Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis një institucioni publik dhe individit, e cila rregullohet nga ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.* Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: *“Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:..c) kushtet e punës dhe punësimin, përfshirë zgjedhjen e kontratës së punës dhe pagën”.*

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimtimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës*

²² Livio Paladini, “Diritto Costituzionale”, CEDAM, Padova, 1991, fq. 166-175.

²³ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i GJK.

private dhe familjare”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh, duke parashikuar dhe çdo status tjetër, si shkak të mbrojtur.

Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore²⁴”, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë.

Konventa nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës²⁵ *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi.

Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion.

Karta Sociale Europiane²⁶ në nenin 1, pika 2, parashikon: *“ Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2. të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...”* Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim²⁷.

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të

²⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

²⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

²⁶ Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

²⁷ Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, prg 30.*

mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme²⁸.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD-së përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur ti mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale (KEDS) gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar²⁹ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër, në këtë rast shoqërisë Albpetrol sh.a, e cila duhet

²⁸ Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.

²⁹ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar prej tij.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “*Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim*”.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara*³⁰”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues.

Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

³⁰ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Nëse Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.³¹

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Përsa i përket shkakut të bindjeve politike, Komisioneri vlereson se jemi në kushtet e nenit 3, pika 4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë*”. Në këtë kuptim, jemi në kushtet kur shkakun e diskriminimit nuk e mbart drejtpërdrejtë ankuesi, por personi që shoqërohet apo supozohet që shoqërohet me të. Në rastin konkret, bindjet politike i mbart J. T., si përfaqësuese e lartë e Partisë Demokratike, shoqërues i së cilës ka qenë ankuesi në kuader të funksionit të tij si punonjës i Gardës së Republikës së Shqipërisë. Bazuar në informacionin e administruar, rezulton se ai etiketohet publikisht³² nga strukturat drejtuese të Partisë Socialiste, si përkrahës i Partisë Demokratike dhe për faktin që ka qenë shoqërues i një prej drejtuesve më të lartë të këtij subjekti politik.

Sipas informacionit të administruar në faqen web³³ të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në rubrikën ku citohet jetëshkrimi i G. G, ndër të tjera thuhet se: *“...Në qershor 2007 deri më shtator 2013 G. G ka mbajtur postin e Krye-Financierit të Partisë Socialiste të Shqipërisë. Ndërkohë në vitin 2011 ai është angazhuar aktivisht në qeverisjen e qytetit të Tiranës duke u zgjedhur si anëtar dhe kryetar i Grupit të Këshillit në Bashkinë e Tiranës, post të cilin e ka mbajtur deri në vitin 2015...Në 1 tetor 2020 G. G emërohet Drejtor i Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave...”*.

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : *“Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim ”*, nuk lind nevoja për verifikim.

Pra, nga sa më sipër cituar, G. G ka patur një aktivitet të njohur politik, si pjesë e strukturave të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Gjithashtu, sa i përket informacionit dhe provave të administruara, rezulton se më datën 23.02.2021 nëpërmjet e-mailit dhe me shkresën nr. 3702 prot., datë 24.02.2021, i është drejtuar punëdhënësit të tij, me një letër denoncuese për kontrabandën që bëhej në sistemin doganor shqiptar.

³¹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

³² Referuar analizës së bërë në paragrafin I, faja 25 e këtij vendimi.

³³ <https://dogana.gov.al/dokument/3436/cv-g.-g>.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr. 5172/1 prot., datë 17.03.2021, ka vendosur për: *“Zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të M. L. më detyrë Përgjegjës Sektori, Sektori i Antikontrabandës Detare në Drejtorinë e Antikontrabandës, pranë Departamentit Operativ Hetimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”*.

Përsa më sipër, rezulton se në një periudhë kohore më pak se 1 (muaj), pas denoncimit të ankuesit për korrupsionin e ushtruar nga ana e strukturave doganore, ka ardhur largimi i tij, pa i dhënë të drejtë për tu dëgjuar, si dhe pa u thirrur në respektim të procedurave të parashikuara nga Kodi i Punës, cituar në analizën e bërë në këtë vendim.

Në këtë kuadër, Komisioneri arrin në konkluzionin se ndodhemi në kushtet e prezumimit dhe dyshimit të arsyeshëm të diskriminimit të ankuesit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për shkaqet e pretenduara prej tij.

Përsa më sipër, Komisioneri evidenton se në rastin konkret, shkakun e bindjeve politike dhe ai i denoncimit, kanë bashkëvepruar me njëri tjetrin, në mënyrë të pandashme dhe të kombinuar, duke bërë që trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm i ankuesit, të lidhet drejtpërdrejtë me këto shkaqe. Pra, Komisioneri vlerëson se jemi në kushtet e nenit 3, pika 3 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit*”. Në këtë kuptim, jemi në kushtet kur trajtimi i padrejtë dhe i pafavorshëm, lidhet në të njëjtën kohë me shkakun e bindjeve politike, në formën e shoqërimit dhe denoncimeve, në formën e diskriminimit të drejtpërdrejtë.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk arriti të provonte përpara Komisionerit se ankuesi nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.

Pra në përfundim, Komisioneri konstaton se:

- Që në momentin e rikthimit në punë, mbështetur në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, ndaj ankuesit filloi trajtimi i pafavorshëm dhe i padrejtë, duke e liruar nga shërbimi civil dhe duke e emëruar në një pozicion pune i cili nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil;
- Në vijim, menjëherë pas emërimit në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, të G. G. rreth 1 (një) muaj më vonë, ankuesi u transferua në një pozicion pune të një kategorie më të ulët, duke u transferuar nga pozicioni që mbante si Drejtor i Antikontrabandës, si nëpunës i kategorisë A, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Antikontrabandës Detare, si nëpunës i kategorisë B;
- Gjithashtu, zgjidhja e marrëdhënieve të punës së ankuesit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, u bë në mënyrë të menjëhershme dhe në shkelje të legjislacionit të punësimit, siç është parashtruar në rubrikën A të këtij vendimi;

- Pavarësisht faktit që ankuesi si një punonjës i cili sinjalizoi aktet korruptive të strukturave doganore duhej mbrojtur (referuar analizës së bërë në rubrikën A të këtij vendimi), nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në formë hakmarrje u bë ndërprerja e menjëhershme e kontratës së punës;
- Në përfundim, nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët, rezultoi se ndaj ankuesit ishte marrë sanksion me gjobë si pasojë e dëmtimit të mjetit që kishte në përdorim, pavarësisht se një procedurë e tillë nuk ishte e parashikuar në asnjë akt ligjor apo nënligjor të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Komisioneri konstaton se largimi i ankuesit nga pozicioni i punës si Drejtor i Antikontrabandës, nuk ka ardhur për arsye të justifikuara.

Pra, siç shihet qartë nga dinamika dhe kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve, analizimi i fakteve në tërësinë e tyre; pasojat negative të subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i kanë ardhur menjëherë pas denoncimeve të bëra lidhur me korrupsionin në strukturat doganore.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkaqeve të pretenduara nga ankuesi dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e punëdhënësit, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet dhe mosveprimet e këtyre subjekteve kundrejt ankuesit ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprime dhe mosveprime ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Për rrjedhojë Drejtoria e Përgjithshme të Doganave ka shkelur dispozitat e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 12, pika 1, gërma “c”.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi krijon bindjen e arsyeshme dhe vlerëson se M. L., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte e bindjes politike të tij dhe denoncimit të korrupsionit dhe kontrabandës së bërë nga ana e strukturave doganore.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e lirimit të ankuesit nga detyra, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke e rikthyer ankuesin në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të ankuesit M. L., në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike dhe denoncimeve për kontrabandën e kryer në sistemin doganor shqiptar, në formën e diskriminimit ndërsektorial, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer subjektin ankues në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindja politike dhe çdo shkak tjetër)

(Fusha: Punësim)

(Lloji: Diskriminim ndërsektorial)